



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

Komisioni për Shërbime Publike,  
Administratë Lokale dhe Media  
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës.  
25.04.2008, ora: 13:00, N-10, Nr. 6

**Procesverbal**

Në mbledhje morën pjesë: Esat Brajshori, Fehmi Mujota, Shpresa Murati, Gani Buqinca, Hajdin Abazi, Melihate Tërmerkollli, Ali Lajçi, Anita Morina, Rasim Selmanaj, Synavere Rysha, Radmila Vujovic.

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj-administratore, Drita Morina-zyrtare e lartë ligjore, Fatime Qorri - zyrtare ligjore dhe Mirjeta Heta -nëpunëse administrative;

Mbledhjen e udhëhoqi Esat Brajshori, kryetar i Komisionit, me këtë:

**Rend dite:**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i Projektligjit për Vula në Institucionet e Republikës së Kosovës nr. L – 054/1.
3. Të ndryshme.

**Pika e parë e rendit të ditës -**

Procesverbali u miratua me vërejtjen e znj. Melihate Tërmerkollli për diskutimin e saj.

## **Pika e dytë e rendit të ditës -**

Komisioni shqyrtoi Projektligjin për Vulat në Institucionet e Republikës së Kosovës nen për nen, pas shqyrtimit të projektligjit në tërësi, Komisioni hartoi këto propozim - amendamente:

### **Amendamenti 1**

**Neni 6.3**, Në tekstin në gjuhën serbe dhe angleze pas fjalës **“institucioneve”**, shtohet fjala **“komunale”**.

### **Amendamenti 2**

**Neni 12.1**, pas fjalëve “Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/20”, fshihet teksti në vazhdim.

### **Amendamenti 3**

**Neni 15.1**, pas fjalës **“vulës”** fshihet fjala **“së”**.

### **Amendamenti 4**

**Neni 23**, riformulohet si vijon: “Ministria bënë mbikëqyrjen e institucioneve për zbatimin e këtij ligji dhe obligon institucionin të veprojë në bazë të dispozitave të këtij ligji”.

### **Amendamenti 5**

**Neni 25.1 dhe 26.1**, pas shumës 500 fshihen “00” dhe zëvendësohen me fjalë “pesëqind” dhe pas shumës 5.000 fshihen “00” dhe zëvendësohen me fjalë “pesë mijë”.

### **Amendamenti 6**

**Neni 25.2**, pas shumës 250 shtohen fjalët “dyqind e pesëdhjetë” dhe pas shumës 2.500 shtohen fjalët “dy mijë e pesëqind”.

### **Amendamenti 7**

**Neni 28**, riformulohet si vijon: “Gjobat e parapara sipas dispozitave të këtij ligji derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës”.

Mbledhja përfundoi në ora: 15:00

Kryetari i Komisionit:

Esat Brajshori